

Modul për gazetarët  
dhe mediat

# “MBROJTJA E FËMIJËVE NË MASMEDIA”

## PROJEKTI:

DREJTËSIA SOCIALE PËR ROMËT,  
ASHKALITË DHE EGJIPTIANËT

NËNTOR, 2024



# PËRMBAJTJA:

<b>1. Legjislacioni për mbrojtjen e fëmijëve në media .....</b>	<b>7</b>
1.1 Legjislacioni për të drejtat e fëmijëve.....	7
1.2 Legjislacioni vendor dhe ai ndërkombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në media.....	7
1.3 Kodi i Drejtësisë për të Mitur.....	8
<b>2. Parimet bazë në raportimin e mediave për fëmijët.....</b>	<b>11</b>
2.1 Ligji dhe praktika – Pse mediat e shkelin etikën kur raportojnë për fëmijët? .....	11
2.2 Eksplorimi i rrjeteve sociale, me shumë rreziqe për fëmijët.....	12
2.3 Diskutim me raste konkrete për shkeljet e mediave në raport me fëmijët.....	12
<b>3. Identifikimi i fëmijëve në media.....</b>	<b>15</b>
3.1 Raportimi për fëmijët në varfëri.....	15
3.2 Raportimi për fëmijët nga grupet e komuniteteve.....	15
3.3 Raportimi për fëmijët me aftësi të kufizuara .....	16
3.4 Raportimi për fëmijët në fushata zgjedhore.....	16
<b>4. Intervistimi i fëmijëve .....</b>	<b>19</b>
4.1 Zëri i fëmijëve në media.....	19
4.2 Gjashtë parimet e UNICEF-it për raportim.....	19
4.3 Gjashtë udhëzimet për intervistim.....	19
4.4 Shtatë rekomandimet për raportim cilësor .....	20
4.5 Kodi etik i BBC.....	20

# MIRËNJOHJE

Moduli i trajnimit “Mbrojtja e fëmijëve në masmedia” për gazetarë dhe profesionistë të medias është hartuar me mbështetjen e projektit “Drejtësia Sociale për Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët”. Projekti zbatohet nga Terre des Hommes Lausannë në Kosovë në partneritet me organizatën Zëri i Romëve, Ashkalive edhe Egjiptianëve (VoRAE) dhe Swiss Church Aid (HEKS/EPER) dhe financohet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim.

Ky modul trajnimi është rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës (AGK), të cilët i falënderojmë për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e tyre për ta bërë modulin mbi mbrojtjen e fëmijëve në masmedia pjesë të kurrikulës së tyre dhe planit të tyre të trajnimeve.

Moduli i trajnimit mbi mbrojtjen e fëmijëve në masmedia është hartuar nga eksperti, Besian Beha, i cili, përveç përpilimit të modulit, gjithashtu do të mbajë edhe sesione të trajnimeve me gazetarë.

## QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E MODULIT

Fondacioni Terre des hommes Lausannë në Kosovë është duke zbatuar projektin “Drejtësia Sociale për Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët në Kosovë”, në partneritet me organizatën Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VoRAE) dhe Swiss Church Aid (HEKS/EPER).

Qëllimi i përgjithshëm i konsorciumit dhe vizioni është një shoqëri multietnike dhe multikulturore në Kosovë, ku pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian trajtohen si të barabartë nga shteti dhe nga shoqëria, ku kanë qasje dhe mundësi të barabarta sikur të gjithë qytetarët e tjerë dhe ku romët, ashkalitë dhe egjiptianët njohin të drejtat dhe detyrat e tyre.

Qëllimi specifik i këtij moduli dhe i trajnimit në përgjithësi është që t’i ndihmojë gazetarët dhe profesionistët e medias ta kuptojnë rëndësinë e raportimit mbi etikën dhe standardet profesionale për fëmijët, dhe të jenë të vetëdijshëm për ndikimin që kanë raportimet mediale mbi jetën dhe mirëqenien e fëmijëve; t’u mësojë gazetarëve dhe profesionistëve të medias praktikatat më të mira për mbrojtjen e privatësisë dhe ruajtjen e anonimitetit të fëmijëve, veçanërisht në raportimet për rastet më të ndjeshme, siç janë ato të abuzimit apo të dhunës. Gjithashtu, qëllim tjetër është t’i ndihmojë gazetarët të kuptojnë se cilat janë pasojat e një raportimi të papërgjegjshëm, joprofesional dhe në kundërshtim me parimet etike; t’i ndihmojë ata të zhvillojnë qasje të kujdesshme dhe të përgjegjshme në raportim; dhe t’i ndihmojë gazetarët të kenë qasje të ekuilibruar në përfaqësimin e fëmijëve, duke shmangur stereotipet dhe stigmatizimin.

Në kohën kur e gjithë bota është përfshirë nga shpërthimi i rrjeteve sociale, përgjegjësia e mediave për ruajtjen e profesionalizimit, raportimit etik dhe të bazuar në burime zyrtare e të konfirmuara, është më e nevojshme se asnjëherë tjetër. Kur është fjala për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në media, të gjitha këto parime e kërkesa, vetëm sa duhet të fuqizohen.

Ky modul trajnimi për gazetarë dhe profesionistë të medias, ndërlidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në media, ka pikërisht këtë qëllim. Pra, rritjen e njohurive, avancimit të përgatitjes profesionale dhe përmirësimit të nivelit të raportimit tek gazetarët, me fokus në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Duke zhvilluar diskutime, debate, krahasime e punë praktike, synohet që gazetarët, kryesisht ata më të rinj, e profesionistët e tjerë të mediave, të fitojnë një pamje më të qartë se cila është gjendja reale në sferën mediale në Kosovë në aspektin e mbrojtjes së fëmijëve, dhe cilët duhet të jenë hapat e ardhshëm në përmirësimin e situatës aktuale. Përmirësimi dhe adresimi i sfidave drejt të ardhmes, nëpërmjet këtij moduli, do të bëhet duke ofruar praktikatat më të mira nga organizatat vendore e ato ndërkombëtare, dhe medime prestigjioze si BBC, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në media. Nëpërmjet materialeve konkrete, standardeve profesionale e etike, do të synohet që të identifikohen problemet aktuale dhe adresimi i sfidave me të cilat përballen mediat në raportimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Fillimisht moduli do t'i njoftojë gazetarët dhe profesionistët e medias me aspektin ligjor të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, për të vazhduar deri te legjislacioni vendor e ai ndërkombëtar i cili adreson në mënyrë direkte rregullimin ligjor të mbrojtjes së fëmijëve në media.

Pasi pjesëmarrësit të kenë ide të qarta lidhur me rregullimin ligjor të fëmijëve në media, moduli do të përfshijë prezantimin praktik të gjendjes së mediave në Kosovë, stafit, hierarkisë editoriale e deri te përmbajtjet gazetareske, duke synuar të prezantohet gjendja reale e mediave në Kosovë, ndërlidhur me sfidat që dalin për raportimin për fëmijët.

Veç mediave të cilat janë të regjistruara dhe funksionojnë si të tilla, hapësirë e nevojshme në modul do t'i ofrohet edhe 'eksplodimit' të rrjeteve sociale si TikTok-u, dukurive negative të cilat mund të afektojnë fëmijët, seksualizimit të fëmijëve, duke ofruar edhe shembuj konkretë të pasojave që kanë pasur këto situata për fëmijët në Kosovë.

Moduli do të ofrojë hapësirë për diskutime dhe raste konkrete ku mediat në Kosovë kanë shkelur etikën kur kanë raportuar për fëmijët. Kryesisht në raste të kronikës së zezë, vrasje e vepra të tjera, të cilat kishin pasur shumë vëmendje në Kosovë. Duke prezantuar këto raste, pjesëmarrësit do të kenë ide më të qarta për rreziqet e raportimit joetik në media, si dhe evidentimin e dallimit mes interesit publik dhe interesimit të publikut. Pas diskutimeve, moduli synon të ofrojë mundësi që gazetarët të improvizojnë raportime të ngjashme, por duke shmangur shkelje etike të mediave.

Në një shoqëri si kjo e Kosovës, mediat kanë barrën kryesore të ruajtjes së interesit publik, duke shmangur raportimet joprofesionale të cilat gjithashtu mund të nxisin dhunë e gjuhë të urrejtjes. Që kjo të mos ndodhë, moduli do të përfshijë edhe specifikat dhe parime ndërkombëtare të cilat ndërlidhen me kujdesin që duhet ta kenë gazetarët për identifikimin e fëmijëve kur raportojnë për tema të ndryshme.

Mediat në Kosovë, përveç përgjegjesisë për raportimin korrekt e të kujdesshëm kur temat ndërlidhen me fëmijë, kanë përgjegjësi që të jenë zë edhe për kategoritë e fëmijëve që nuk dëgjohen. Mediat në Kosovë duhet të raportojnë, shpesh por dhe kujdesshëm, për fëmijët në varfëri, për fëmijët nga grupet e komuniteteve, fëmijët me aftësi të kufizuara.

Vija e hollë që ndan fuqizimin e këtyre grupeve, me rrezikun e një tjetër diskriminimi në rast të përdorimit të gjuhës jo të për-shtatshme, do të jetë subjekt trajtimi në modulin për mbrojtjen e fëmijëve në masmedia. Shumë shpesh, mediat ose nga ngutësia ose nga mosinformimi i gazetarëve, përdorin terminologji jo të duhur kur është fjala për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Secili prej këtyre komuniteteve ka kultura, tradita e tipare të ndryshme, si rezultat përdorimi i termit "RAE", me qëllimin për t'i përfshirë të tri komunitetet, është i gabueshëm dhe ofendues.

Në shumë edicione informative, raportime të gazetarëve e portale, mund të shohësh intervista të fëmijëve të cilat, në disa raste, në thelbin e tyre kanë lexueshmërinë më shumë se profesionalizmin. Andaj, për këtë situatë, moduli do të prezantojë këshilla për gazetarë për intervistimin sa më profesional të fëmijëve. Gjithashtu do të prezantohen këshilla e rekomandime nga UNICEF-i, si dhe detaje nga kodi etik i BBC-së.

Përmbajtja e hulumtimit do të përmbajë edhe rezultate studimesh e hulumtimesh që janë bërë me gazetarë e redaktorë të mediave në Kosovë.

## SESIONI I:

Sesioni 1/Temat	Kohëzgjatja	Metodologjia
1. Legjislacioni për mbrojtjen e fëmijëve në media		
1.1 Legjislacioni vendor dhe ai ndërkombëtar për të drejtat e fëmijëve	20 min	Do të paraqiten konventat e ligjet kryesore ndërkombëtare të cilat rregullojnë të drejtat e fëmijëve, përfshirë Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.
1.2 Legjislacioni vendor dhe ai ndërkombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në media	20 min	Prezantimi i ligjeve e kodeve vendore e ndërkombëtare, të cilat përcaktojnë në mënyrë strikte si mediat duhet të raportojnë për fëmijët, përfshirë Kodin Etik të KPM-së, KMSHK-së etj.
1.3 Kodi i Drejtësisë për të Mitur	20 min	Kodi i Drejtësisë për të Mitur parasheh obligime të qarta ndërlidhur me konfidencialitetin e procedurave kur në raste të ndryshme janë të përfshirë fëmijët.
Diskutim: Perceptimet hyrëse të pjesëmarrësve për mënyrën si mediat raportojnë për fëmijët	30 min	

### Objektivat:

- Prezantimi i obligimeve, kushteve dhe rekomandimeve kryesore të cilat dalin nga legjislacioni vendor dhe ai ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në aspektin e përgjithshëm.
- Prezantimi i të gjitha elementeve që dalin nga Kodi Etik për gazetarë, kodet vendore e ato ndërkombëtare të cilat kanë kushte strikte për mënyrën se si gazetarët duhet të raportojnë tema që ndërlidhen me fëmijët.

### Rezultatet e pritura:

Njohja dhe familjarizimi i pjesëmarrësve së pari me parimet bazike të të drejtave të fëmijëve, përfshirë të drejtën që zëri i tyre të dëgjohet në media, por në formën e duhur. Zhvillimi dhe avancimi i njohurive në detaje me legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtar ku parashihen rregullat dhe parimet etike e profesionale, mbi të cilat gazetarët duhet të jenë të vëmendshëm për mbrojtjen e fëmijëve në media.

# 1. Legjislacioni për mbrojtjen e fëmijëve në media

Duke qenë në garë shpesh me shpejtësinë, me betejën për më shumë klikime, mediat dhe gazetarët në disa raste tejkalojnë Konventat dhe Ligjet vendore e ndërkombëtare, të cilat kanë paraparë rregullim strikt se cilat janë të drejtat e fëmijëve në përgjithësi. Leximi dhe hulumtimi i këtyre dokumenteve, në kohën kur ka një zhvillim të madh teknologjik, është kthyer në diçka të domosdoshme.

Raportimi nuk nënkupton vetëm prezantimin e fakteve të cilat një gazetar i ka grumbulluar gjatë punës në terren. Nënkupton edhe fuqizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të kategorive më të ndjeshme në shoqëri, siç është rasti me fëmijët. Duke qenë kështu, përgjegjësia për raportim të përgjegjshëm e profesional, veç mbrojtjes së interesit publik, shkon edhe më tutje duke synuar mbrojtjen e fëmijëve në një sistem medial i cili çdo ditë e më shumë po ballafaqohet me sfida të reja.

Një hulumtim i fundit i realizuar nga organizata "Save the Children Kosova" ka zbardhur se fëmijët në Kosovë e shohin TikTok-un si platformën ku bullizohen më së shumti.<sup>1</sup> Sipas këtij hulumtimi, 78% e nxënësve kanë deklaruar se bullizimi është shumë i pranishëm, ose mesatarisht i pranishëm në shkolla. Ky bullizim vjen më shumë si pasojë e rrjeteve sociale të cilat në disa raste kanë pasur edhe pasoja me lëndime trupore për fëmijët në Kosovë. Këto statistika sigurisht kanë ngritur alarmin për një edukim të mirëfilltë medial, i cili shton edhe obligimet e mediave në mënyrën se si raportojnë duke përfillur kodet etike.

Në mënyrë që mediat t'i kenë obligimet e tyre të qarta, ekzistojnë me dhjetëra konventa, kode e ligje ndërkombëtare e vendore të cilave gazetarët duhet t'iu përmbahen. Pavarësisht kësaj, zbatimi i tyre në praktikë shpesh ka qenë sfidues. Me këtë qëllim, nëpërmjet këtij sesioni, do të synohet që gazetarët e profesionistët e medias të kenë një pamje të qartë, konkrete dhe të përgjithshme, me kushtet të cilat duhet t'i zbatojnë kur raportojnë për fëmijët.

## 1.1 Legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Ajo që është më e rëndësishme në fillim është të kuptohen saktë e drejtë të drejtat thelbësore që kanë fëmijët në secilin aspekt. Kjo duke përfshirë nga edukimi, privatësia, shkollimi, argëtimi etj. Të gjitha këto janë të përcaktuara me një legjislacion vendor e ndërkombëtar, i cili do të prezantohet në këtë sesion.

Në aspektin ndërkombëtar, Konventa më e njohur dhe më e rëndësishmja është Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve. Konventa për të drejtat e fëmijëve është një traktat ndërkombëtar i miratuar nga Kombet e Bashkuara, që mbron të drejtat e fëmijëve dhe siguron që ata të trajtohen me dinjitet dhe respekt.<sup>2</sup> Në nivel evropian e ndërkombëtar, ka edhe rregullime të tjera ku përcaktohen në detaje të drejtat e fëmijëve në secilën fushë të jetës.

Në Kosovë, të drejtat e fëmijëve rregullohen duke nisur nga dokumenti më i rëndësishëm për një republikë demokratike, që është Kushtetuta e Kosovës. Neni 50 i Kushtetutës garanton të drejtën e fëmijëve për mirëqenie, jetë të pavarur dhe të mbrojtur nga dhuna.<sup>3</sup> Kurse, me një ligj specifik siç është Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, përcaktohen të gjitha të drejtat që në Kosovë u garantohen fëmijëve.<sup>4</sup>

## 1.2 Legjislacioni vendor dhe ai ndërkombëtar për të drejtat e fëmijëve në media

Përveç dokumenteve bazë të cilat përcaktojnë mbrojtjen në përgjithësi të të drejtave të fëmijëve, ekziston legjislacioni i qartë që përcakton edhe mbrojtjen e fëmijëve në media. Duke nisur nga legjislacioni ndërkombëtar, por konkretisht edhe legjislacioni në Kosovë.

<sup>1</sup> Raporti i Save the Children: <https://www.dukagjini.com/save-the-children-tiktok-u-hapesira-ku-bullizohen-me-se-shumti-femijet-ne-kosove/>

<sup>2</sup> Konventa për të Drejtat e Fëmijëve - <https://shorturl.at/v80Iz>

<sup>3</sup> Kushtetuta e Kosovës - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>4</sup> Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës - <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

Për të pasur një ide më të qartë se cilat janë ligjet, kodet, dhe dokumentet më të rëndësishme që përcaktojnë kriteret për raportim profesional dhe ruajtjen e etikës për mbrojtjen e fëmijëve, në këtë sesion do të paraqitet aspekti ligjor që përfshin udhëzimet, por edhe pasojat, nëse gazetarët nuk veprojnë sipas këtyre dokumenteve.

Në Kosovë janë disa institucione të cilat kanë për detyrë të merren me trajtimin dhe raportimet e gazetarëve, kur ato bien ndesh me parimet profesionale. Për mediat audiovizuale është Komisioni i Pavarur për Media. Për mediat e shkruara ekziston institucioni vetërregullues, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës. Që të dy këto institucione, në forma të ndryshme, trajtojnë dhe shqyrtojnë ankesat e palëve ndaj mediave. Përfshirë edhe ato që ndërlidhen me fëmijët.

Madje, Ligji për KPM-në fillimisht, me një nen të veçantë, e rregullon Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Media.<sup>5</sup> Kurse, KPM-ja së fundmi gjithashtu ka hartuar një rregullore të veçantë e cila trajton vetëm specifikat e raportimit të mediave për fëmijët.<sup>6</sup>

Për identifikimin, kujdesin dhe pasojat që ka raportimi jo i duhur për fëmijët flet edhe Kodi i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës në nenin 6.<sup>7</sup> Për të gjitha detajet, kushtet dhe përmbajtjet e këtyre rregulloreve, pjesëmarrësit do të njoftohen deri në detaje gjatë këtij sesioni.

Sesioni gjithashtu ka për qëllim t'i njoftojë pjesëmarrësit me disa prej rregullave ndërkombëtare, parimeve të Bashkimit Evropian, të cilat përcaktojnë në mënyrë strikte kushtet dhe formën e raportimit me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve në media. Disa prej këtyre dokumenteve janë: Direktiva për Shërbimet e Mediave Audiovizive (Bashkimi Evropian), Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet, Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve në BE, Korniza e Mbrojtjes së Fëmijëve nga Përmbajtjet e Dëmshme, Kodet e rregullimit dhe vetërregullimit.

Përveç tyre, institucionet e BE-së por edhe ato ndërkombëtare trajtojnë këto aspekte edhe me rregullativa tjera të veçanta, por edhe vetë mediat me institucione vetërregulluese, duke synuar raportim profesional dhe të bazuar në kriteret.

### 1.3 Kodi i Drejtësisë për të Mitur

Një prej dokumenteve që përcakton në mënyrë të qartë ruajtjen e konfidencialitetit për rastet kur bëhet fjalë për fëmijët është Kodi i Drejtësisë për të Mitur. I dukur në pamje të parë si një rregullim krejtësisht juridik, Kodi i Drejtësisë për të Mitur është përmendur tejet shpesh në mediat e Kosovës. Kjo ndërlidhur me raste të ndryshme të kronikës së zezë, ku të përfshirë kanë qenë edhe fëmijët.

Sipas platformës Hibrid që merret me monitorimin e mediave, rastet më të shpeshta kur mediat në Kosovës përdorin Clickbait janë ato të kronikës së zezë.<sup>8</sup>

Mediat kosovare, duke synuar shpejtësinë dhe lajmet që nxisin klikime, në shumë raste të tilla si vrasje, dhunë dhe vepra të tjera penale ku përfshihen fëmijët, kanë raportuar duke zbuluar informata identifikuese për fëmijët e përfshirë, gjë që përbën shkelje të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

<sup>5</sup> Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2809>

<sup>6</sup> Rregullorja e KPM-së për Mbrojtjen e Fëmijëve: <https://shorturl.at/9x9FZ>

<sup>7</sup> Kodi i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës: <https://shorturl.at/XjsMw>

<sup>8</sup> Raporti i Hibrid: <https://shorturl.at/TBBPY>



Pikërisht, ky aspekt do të trajtohet në këtë sesion. Pjesëmarrësit do të njoftohen me përcaktimet e qarta ligjore që dalin nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur, e ku një pjesë flet edhe për publicitetin e procedurave në raste ku të përfshirët në vepra penale janë fëmijë. Sesioni do të synojë të ofrojë përgjigje në disa prej pyetjeve si: Cilat informata lejohet të publikohen në raste kur fëmijët janë të përfshirë në vepra penale? Kush e jep lejen për nxjerrjen në publik të ndonjë informacioni? Cilat janë pasojat nëse këto dispozita nuk respektohen?

Raportimi nga Gjykatat dhe nga rastet e tilla ku në pah është dhuna në një formë apo tjetrën ka pas vetes edhe shumë dilema, duke nisur nga dhënia e detajeve e deri te mënyra se si duhet të sillen gazetarët në Gjykata apo Prokurori kur raportojnë për raste të tilla. Kur bëhet fjalë për fëmijët, atëherë interesimi për informacion është edhe më i madh, pasi seancat janë të mbyllura. Si rezultat, në shumë raste, gazetarët synojnë të marrin informata në burime anonime, të cilat më pas mund të jenë sfiduese për etikën, dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Me këto të dhëna, do të synohet që për pjesëmarrësit të ofrohet një pamje më e qartë se deri në cilën pikë mund të kërkohet e publikohet një informacion për të mitur, pa i identifikuar të njëjtit. Si rezultat, do të ketë edhe një diskutim me pjesëmarrësit dhe shkëmbim të përvojave.

## PËRMBLEDHJE:

Në kohën kur interneti, lajmet, rrjetet sociale janë në nivelet më të larta të përdorimit, kur informatat dominojnë në secilën platformë, njohja e rregullimit ligjor, kritereve, pasojave dhe specifikave të tjera është e rëndësishme së jashtëzakonshme. Kjo bëhet me vlerë edhe më të madhe kur fjala është për raportimin për një kategori tejet të veçantë si ajo e fëmijëve.

Rregullimi ligjor në shumë raste vlerësohet si diçka teknike, megjithatë njohja dhe konsultimi me dokumentet e rëndësishme, të cilat parashohin specifikat e raportimit për fëmijët, është e vlefshme dhe duhet të bëhet në vazhdimësi.

### SESIONI II:

Sesioni II – Temat	Kohëzgjatja	Metodologjia
2. Parimet bazë në raportimin e mediave për fëmijët		
2.1 Ligji dhe praktika: Pse mediat e shkelin etikën kur raportojnë për fëmijët?	30 min	Sesioni do të fokusohet në paraqitjen e gjendjes faktike në të cilën janë mediat në Kosovë. Sfidat, problemet, mangësitë, të cilat më pas çojnë në një raportim me shumë dilema për mbrojtjen e fëmijëve. E kujt është përgjegjësia: e gazetarëve apo e mediave si kompani?
2.2 Eksplozimi i rrjeteve sociale, me shumë rreziqe për fëmijët	30 min	Rëndësia e edukimit medial është jetike në realitetin e sotëm. Rrjetet sociale janë kthyer në burimin kryesor të jetës, duke bërë që në shumë raste të kenë edhe rreziqe. Sesioni do të ofrojë detaje për raste konkrete ku rrjetet sociale kanë shkaktuar pasoja për fëmijët.
2.3 Raste konkrete: Shkeljet e mediave në raport me fëmijët	60 min	Në këtë pjesë do të prezantohen 5 raste ku mediat në Kosovë është konstatuar se kanë bërë shkelje etike në raportimin për tema ku kanë qenë të përfshirë fëmijët. Këto kryesisht janë raste të kronikës së zezë, me zbulim të informatave të cilat kanë çuar te identifikimi, gjuha e urrejtjes dhe stigmatizimi i personave të përfshirë.

## Objektivat:

- Ofrimi i një pasqyre reale të gjendjes së mediave në Kosovë: sfidat, problemet dhe aspekti menaxherial me pasojë direkte në përmbajtjen gazetareske.
- Roli i edukimit medial në ofrimin e njohurive sa më të thella për rreziqet dhe mënyrën se si duhet të shfrytëzohen mediat sociale nga fëmijët.
- Njohuri për raste konkrete të shkeljeve nga mediat, përmirësimi i tyre dhe angazhimi i përbashkët që fokusi të jetë në interesin e publikut e jo në interesimin e publikut.

## Rezultatet e pritura:

Informata dhe përditësim nga gazetarët për funksionimin e mediave në Kosovë, ndërlidhjen e mediave me rrjetet sociale dhe rreziqet që kanë në rast të keqpërdorimit secila prej tyre. Dallimi ndërmjet interesit publikut dhe interesimit të publikut, si një prej faktorëve më të rëndësishëm në raportimin e përditshëm, sidomos në mbrojtjen e fëmijëve. Zbërthim i saktë i definicionit të edukimit medial dhe rolit të tij në përmirësimin e hapësirës mediale në Kosovë.

## 2. Parimet bazë në raportimin e mediave për fëmijët

Përgjegjësia e mediave për ruajtjen e identitetit, intervistimit të saktë, informatave konkrete, burimeve faktike, në raport me fëmijët, dhe jo vetëm, është bazë për punën e përditshme. Megjithatë, në kohën kur shumë faqe në rrjete sociale kanë marrë vëmendjen kryesore, janë kthyer në burime të informimit, kjo nuk është aq e thjeshtë.

Në mënyrë që mediat ta ruajnë besueshmërinë dhe profesionalizmin, raportimi mbi baza ditore për rastet ku janë të përfshirë fëmijët, duhet të jetë i kujdesshëm, pa stereotipe, pa paragjykime dhe që është më e rëndësishmja, pa shkelur kodet e ligjet në fuqi.

Asnjë gazetar e asnjë media nuk duhet ta harrojë njërin prej parimeve më të rëndësishme në raportimin e përditshëm ku në kryeqendër janë fëmijët: fëmijët janë interesi më i madh. Pra, kur temë e subjekt janë fëmijët, nuk duhet të ketë tjetër interes më të madh. E ardhmja e fëmijëve, rreziku nga stigantizimi e bullizimi, duhet të jenë në qendër të vëmendjes në secilën shkronjë që një gazetar e hedh në letër.

Prej parimeve më të rëndësishme, të cilën e përmban edhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur në Kosovë, është se fëmijët kanë të drejtën absolute për privatësi. Dhe, në Kosovë, ky parim shpesh është thyer. Ky sesion do të tregojë pse është thyer, në cilat raste, dhe me çfarë qëllimesh. Raportimi i saktë dhe profesional, jo vetëm për fëmijët, por veçanërisht për fëmijët, duhet të jenë parimet bazë për secilën kronikë e artikull që del në media. Vetëm në këtë mënyrë bëhet luftimi i paragjykimeve, e në të kundërtën, ekziston rreziku për t'i shtuar ato.

Kur bëhet fjalë për fëmijët dhe të drejtat e tyre në media, pavarësisht sfidave, fëmijët gëzojnë të drejtën e plotë të prezantimit në hapësirën mediale në Kosovë. Prej parimeve më të rëndësishme është se mediat janë në shërbim të fëmijëve dhe pjesëmarrja e fëmijëve në media duhet të jetë e domosdoshme.

### 2.1 Ligji dhe praktika: Pse mediat e shkelin etikën kur raportojnë për fëmijët?

Përtej një rregullimi ligjor tejet të rëndësishëm, përtej parimeve të shkruara gjithashtu me rëndësi të madhe, konteksti medial në Kosovë është prej arsyeve më të rëndësishme pse raportimi për fëmijët në Kosovë është sfidues. Tash e disa vjet në Kosovë nuk ka gazeta të shtypura. Përgjegjësinë më të madhe të raportimit e kanë mediat online (portalet) dhe televizionet.

Beteja për lajmin më të shpejtë në mes të mediave online ka bërë që në shumë raste edhe fëmijët të jenë cak i raportimeve joetike. Lajmet e shpejta, të publikuara pa konfirmimin e të gjitha palëve, duke identifikuar persona të përfshirë në ngjarje të shumta, janë vetëm disa nga dukuritë të cilat vlerësohen se po e dëmtojnë efektin e mediave kur raportojnë për fëmijët.

Pjesëmarrësit në këtë sesion do të njihen në detaje me hapësirën aktuale mediale, sfidat me të cilat ajo përballet, dallimet në raportim ndërmjet portaleve dhe televizioneve dhe detaje të tjera të rëndësishme. Portalet kryesisht ballafaqohen me staf të vogël dhe mungesën e një hierarkie të qartë, e që përbën një prej faktorëve për problemet që janë shkaktuar në kontekstin aktual medial. Në anën tjetër, zinxhiri i hierarkisë dhe kontrollit para publikimit të një kronike në televizione është shumë më strikt, e si rezultat gabimet janë më të pakta.

Kulminacioni i gjithë kësaj situatë është edhe aspekti financiar në media. Lajmet e shpejta përbëjnë klikime. Klikimet sjellin para, me të cilat edhe menaxhohet stafi nëpër media. Pra, duke nisur nga zinxhiri i hierarkisë, artikujt e përditshëm, raportimi për fëmijët çon deri te problemi i aspektit financiar nëpër media, që nuk do të duhej të përdorej në asnjë mënyrë si arsye për keqinformimin lidhur me raportimet për fëmijët.

Një pjesë e madhe e mediave në Kosovë nuk kanë zyrë ligjore, si rezultat në shumë raste gazetarët nuk mund të jenë në dijeni për pasojat ligjore që mund të sjellë një raportim jo i duhur, duke mos përfillur në këtë rast Ligjet dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Sesioni do t'i njoftojë pjesëmarrësit me disa rekomandime për adresimin e këtyre sfidave, në mënyrë që interesi publik dhe interesi i fëmijëve të jetë mbi të gjitha në raportimet e përditshme mediale.

## 2.2 'Eksplodimi' i rrjeteve sociale, me shumë rreziqe për fëmijët

Sot, përgjegjësia për mbrojtjen e fëmijëve në media, si asnjëherë më parë, ka tejkalar mediat reale. Secili sot e ka në dorën e tij një media, me të cilën mund të dëmtojë, nxis urrejtje, përçajë e dëmtojë fëmijët. Në kohën kur e gjithë bota po përballet me një vllug të madh të përdorimit të rrjeteve sociale të cilat në shumë raste janë edhe të pakontrolluara, përgjegjësia për një edukim medial të mirëfilltë është më e nevojshme se asnjëherë më parë.

Mediat reale në shumë raste vuajnë barrën e një situatë të tillë, që shpesh quhet edhe kaotike. Mediat reale përzihen me faqe të ndryshme në rrjete sociale, pa autor, pa pronar, pa adresë, e të cilat me fotografi e video të ndryshme mund të dëmtojnë kauza më të mëdha. Si rezultat, kritikant ndonjëherë ndaj mediave, adresohen edhe kur nuk kanë përgjegjësi. Kjo çon sërish në rëndësinë që ka edukimi medial, pra që audiencia të jetë në gjendje t'i dallojë mediat reale, nga ato fiktive, informacionin kredibil me atë të dyshimtë.

Vetëm në muajt e fundit, rrjetet e ndryshme sociale kanë qenë në krye të diskutimeve në Kosovë. Si pasojë e disa lojërave në rrjetin social TikTok, në disa shkolla në Gjakovë u evidentuan disa nxënës që e lënduan veten.<sup>9</sup>

Si pasojë e rrjeteve sociale, në Kosovë kohë më parë shpërtheu skandali me grupin 'Albkings' ku qindra gra, përfshirë edhe vajza të mitura, u kthyen në subjekte të seksualizimit nga persona të ndryshëm. Vetëm këto dy raste dëshmojnë se sa është i rëndësishëm bashkërendimi institucional, në mënyrë që një kategori si fëmijët të shmangjet nga pasojat e këtyre situatave. Jehona e madhe që kanë krijuar rrjetet sociale ka çuar në tjetër nivel rëndësinë e angazhimit të mediave serioze e reale që të mos bëhen pjesë keqinformimit me pasoja për fëmijët. Duke ditur rrezikun nga bullizimi e stigmatizimi, futja e edukimit medial në shkolla mbetet një prej projekteve më të rëndësishme që duhet të planifikohet, madje duke e bërë edhe lëndë obligative.

## 2.3 Rastet konkrete – Shkeljet e mediave në raport me fëmijët

Në kohën kur përdorimi i mediave online në Kosovë është në nivelin më të lartë, gara mes portaleve për lajme të shpejta, për tituj 'clickbait' dhe synimi për ta ofruar informacionin më shpejt sesa më saktë, ka bërë që në shumë raste mediat të përballen me shkelje të ndryshme, sidomos në raste kur subjekt janë fëmijët. Situata të tilla kanë ndodhur kryesisht në ngjarje të kronikës së zeze ku të përfshirë kanë qenë fëmijët, qofshin ato vrasje, dhunime, sulme seksuale, rrahje apo krime të formave të tjera. Me pjesëmarrësit do të diskutohen 5 raste të mëdha në Kosovë lidhur me raportimin për fëmijët, ku pati dilema për shkelje etike e profesionale. Kjo do të bëhet me fotografi, video, si dhe një diskutim mbi të gjitha detajet e raportimeve.

### Rastet – Vrasje: Vrasja e Aulon Zekës dhe vrasja e Lulzim Fejzullahut

<https://www.botasot.info/lajme/761608/detaje-te-tmerrshme-nga-shoqeria-pas-tre-plumbave-riga-e-preu-ne-fyt-aulonit/>

<https://www.botasot.info/aktuale-lajme/762070/ky-eshte-polici-babai-i-vajzes-qe-dyshohet-se-eshte-e-perfshire-ne-vrasjen-e-aulonit/>

<https://www.panorama.com.al/vrasesi-i-16-vjecarit-djali-i-nje-ish-drejtori-te-larte-ne-kosove-foto/>

<https://insajderi.org/keta-jane-dy-te-dyshuarit-qe-goditen-per-vdekje-18-vjecarin-ne-podujeve/>

<https://sinjali.com/keta-jane-dy-te-dyshuarit-qe-e-goditen-me-veture-dhe-rrahen-per-vdekje-18-vjecarin-nga-podujeva/>

<https://zeri.ai/bota/djemte-e-biznesmeneve-i-moren-jeten-18-vjecarit-jetim-kush-jane-autoret-e-r-i190364>

<sup>9</sup> Artikulli në media: <https://kallxo.com/lajm/loja-ne-tiktok-dyshohet-se-nxiti-edhe-tri-nxenes-ne-gjakove-te-lendojne-veten-ne-duar/>

## Dhunimet dhe sulmet seksuale: Dhunimi i 11-vjeçares në Prishtinë, pamjet e sulmit seksual në një prej shkollave fillore në Prishtinë

<https://lajmi.net/e-tmerrshme-dy-femije-te-shkolles-faik-konica-ushtrrojne-dhune-seksuale-ndaj-vajzes-ne-klasen-e-pare/>

[https://www.syri.net/syri\\_kosova/lajme/251420/videon-e-tmerrshme-tek-faik-konica-drejtoresha-e-arsimit-e-quan-loje-femijesh/](https://www.syri.net/syri_kosova/lajme/251420/videon-e-tmerrshme-tek-faik-konica-drejtoresha-e-arsimit-e-quan-loje-femijesh/)

<https://demokracia.com/keta-jane-shtate-te-arrestuarit-qe-dyshohen-per-dhunimin-dhe-trafikimin-e-11-vjecares-ne-muajin-qershor/>

[https://www.syri.net/syri\\_kosova/lajme/406940/me-fotografi-e-emra-keta-jane-5-dhunuesit-e-11-vjecares-foto/](https://www.syri.net/syri_kosova/lajme/406940/me-fotografi-e-emra-keta-jane-5-dhunuesit-e-11-vjecares-foto/)

## Pamjet e fëmijëve nga komunitetet që u ndanë në organizimin e festës së Abetares në shkollën në Pejë.

[https://www.youtube.com/watch?v=h0ZqY\\_cu4LA](https://www.youtube.com/watch?v=h0ZqY_cu4LA)

<https://sinjali.com/e-trishte-nxenesit-nga-pakicat-lihen-anash-ne-festen-e-abetares-ne-peje/><https://insajderi.org/fr/ne-festen-e-abetares-nxenesit-nga-komunitetet-pakice-lihen-anash%E2%82%AC/>

## Përmbledhje:

Konteksti medial në Kosovë po përballet me shumë sfida, në mënyrë që raportimi për fëmijët të jetë tejet korrekt. Përgjegjësia e gazetarëve është e madhe në ruajtjen e interesit publik për fëmijët, megjithatë stafi i vogël nëpër redaksi, mungesa e hierarkisë dhe mungesa e zyrave ligjore, përbën një sfidë në adresimin e problemeve.

Megjithatë, në kohën kur secili përdorues i rrjeteve sociale është kthyer në një 'media' në vete, përveç gazetarëve, përgjegjësia për raportimin e kujdesshëm, edukimin medial, dhe informatat e burimet e sakta, bie mbi institucionet, shoqërinë dhe organizatat, me mediat që qëndrojnë në krye të kësaj hierarkie.

Sesioni III:

Sesioni III/Temat	Kohëzgjatja	Metodologjia
3. Identifikimi i fëmijëve në media	20 min	
3.1 Raportimi për fëmijët në varfëri	20 min	Do të ofrohen shembuj se si publikohen pamje në kundërshtim me kodin etik, ku të përfshirë janë fëmijët. Gjithashtu, do të prezantohen këshilla se si duhet të bëhet raportimi profesional kur subjekt janë fëmijët në varfëri.
3.2 Raportimi për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	20 min	Fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nuk duhet të trajtohen vetëm në aspektin negativ. Duhet të shmangët stigmatizimi dhe gjuha e urrejtjes. Do të ofrohen shembuj praktik të raportimeve nga mediat.
3.3 Raportimi për fëmijët me aftësi të kufizuara	20 min	Trajtimi nga gazetarët duhet të jetë profesional. Gjuha duhet të jetë e përshtatshme, dhe të drejtat e fëmijëve nuk duhet të cenohen. Këshilla për format e duhura të raportimit.
3.4 Raportimi për fëmijët në fushata zgjedhore	20 min	Diskutim dhe ofrim i shembujve konkretë nga zgjedhjet në të kaluarën, dhe fushata për zgjedhjet e datës 9 shkurt.

## Objektivat:

- Pasqyrim i gjendjes reale në hapësirën mediale në Kosovë lidhur me sfidat ku bëhet identifikimi i fëmijëve edhe në rastet kur një gjë e tillë nuk preferohet.
- Krahasimi i shembujve ku mediat në disa raste kanë shkelur etikën, dhe ofrimi i këshillave për raportim sa më cilësor për kategoritë e ndryshme të fëmijëve, bazuar në praktikat ndërkombëtare.
- Diskutim për gjuhën e kujdesshme në raportimet ku subjekt janë fëmijët në varfëri, me aftësi të kufizuara apo nga grupet e komuniteteve.

## Rezultatet e pritura:

Njohuri më të mëdha për raportimin e kujdesshëm kur trajtohen temat për fëmijët nga kategoritë e ndryshme të shoqërisë. Rritja e njohurive për sfidat dhe trajtimin sa më profesional të rasteve kur mediat identifikojnë fëmijët në raportime të ndryshme. Të kuptuarit e këshillave profesionale ndërkombëtare për raportim sa më cilësor për fëmijët e kategorive të ndryshme.

## 3. Identifikimi i fëmijëve në media

Prej sfidave më të mëdha të mediave kur raportojnë për tema të ndryshme për fëmijë është zbulimi i identitetit të tyre në media. Përderisa në sesionin e legjislacionit do të prezantohen kushtet strikte kur lejohet identifikimi i fëmijëve, zbatimi i tyre në aspektin praktik është sfidues si pasojë e një konteksti medial tejet të ngarkuar në Kosovë. Identifikimi i fëmijëve, p.sh., që janë të dyshuar ose të akuzuar për vepra të ndryshme penale, është i rregulluar edhe me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, megjithatë ai shpesh nuk respektohet.

Siç do të prezantohet me disa raste konkrete, mediat shpesh vlerësojnë më shumë interesimin e publikut, se interesin e publikut. Kështu, ato publikojnë emrat dhe mbiemrat, historinë familjare, adresat e fëmijëve të cilët potencialisht mund të kenë qenë të përfshirë në ndonjë situatë, e cila bie ndesh me ligjin. Megjithatë, kjo është rreptësisht e ndaluar, edhe me parimet vendore edhe ato ndërkombëtare.

Mediat e kanë të ndaluar të bëjnë identifikimin me zë e figurë të fëmijëve që mund të jenë të dyshuar për vepra të ndryshme. Nëse interesi i publikut vlerësohet se kapërcen këto rregulla, atëherë lejohet përdorimi i teknologjisë duke mundësuar ndryshimin e zërit dhe mbulimin e pamjes. Imazhet mund të përdoren vetëm me lejen e prindërve, përderisa mediat e kanë të ndaluar të shfrytëzojnë imazhe në nuanca seksuale dhe pamje të fëmijëve në pozicione të papërshtatshme.<sup>10</sup> Rreziku i stigmatizimit dhe bullizimit është tejet aktiv sidomos në shoqëritë si kjo e Kosovës, si rezultat mediat kanë një barrë të madhe që me punën e tyre të mos e mundësojnë një gjë të tillë.

### 3.1 Raportimi për fëmijët në varfëri

Në Kosovë, ndër vite, mediat kanë ofruar emisione të ndryshme ku, në thelb, synimi ka qenë të ndihmohen familjet e varfra. Reportazhet e emisionet e ndryshme kanë përmbajtur pamje të kushteve të rënda, me qëllim që të përçohet mesazhi për ndihmë tek qytetarët, në mënyrë që atyre familjeve t'u ndërtohet shtëpia apo t'u përmirësohen kushtet. Megjithatë, një sfidë e cila rrallë është diskutuar ka qenë pozicioni i fëmijëve të këtyre familjeve në ato kronika.

Në shumë raste, fëmijët janë publikuar me fytyrë, zbathur, me rroba të dëmtuara. Një gjë e tillë, sipas parimeve e kodeve ndërkombëtare ndikon negativisht në imazhin e fëmijëve, në zhvillimin e tyre, në shkollë, dhe në të ardhmen që i pret. Në shumë raste, këta fëmijë janë kthyer në subjekte të bullizimit, duke u përdorur pamjet mbase edhe prej viteve përpara, por të cilat nuk mund të fshihen nga platformat e ndryshme në internet. Duke marrë parasysh këtë, përgjegjësia e mediave në këto raste është që të përkujdesen për mënyrën se si raportojnë për fëmijët, të mos i identifikojnë ata, pasi ato pamje do të mbeten përherë në kujtesën dhe në rrugën drejt të ardhmes për ta.

Në këtë sesion do të ofrohen edhe praktika nga BBC e media të tjera ndërkombëtare për format më të mira të raportimit ku subjekt janë fëmijët në varfëri. Kjo duke përçuar mesazhin e fuqishëm për ndihmë, por në anën tjetër edhe duke u përkujdesur për ruajtjen e identitetit dhe të ardhmes së tyre.<sup>11</sup>

### 3.2 Raportimi për fëmijët nga grupet e komuniteteve

Sfidat pak a shumë të njëjta për mediat dhe gazetarët në raport me mbrojtjen e fëmijëve janë edhe për raportimet për fëmijët nga grupet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Parimi kryesor në këtë sesion është në transmetimin e mesazhit që mediat nuk duhet të raportojnë për fëmijët e komuniteteve, veç në aspektin negativ. Pra, për kushtet e vështira, për jetesën e vështirë. Jo pse raportimet e tilla duhet të shmangen, megjithatë kjo ndikon në krijimin e stereotipeve. Mediat duhet të jenë të zëshme në raportime kur fëmijët nga grupet e ndryshme arrijnë suksese në art, sport, politikë apo çfarëdo fushe tjetër, në mënyrë që të mos ndikojë në krijimin e vetëm imazhit negativ për ta.

<sup>10</sup> Manual për mediat dhe gazetarët lidhur me raportimin për fëmijët nga Instituti Shqiptar i Medias - <https://shorturl.at/sDZ4c>

<sup>11</sup> Reportazh i BBC për fëmijët me Ebolë në Afrikë - <https://www.bbc.co.uk/programmes/b04plw27>

Disa rekomandime për raportimin për fëmijët nga grupet e komuniteteve:<sup>12</sup>

- Fëmijët nuk duhet të portretizohen negativisht për shkak të racës, fesë apo komunitetit.
- Të mos viktimizohen fëmijët e komuniteteve rom, ashkali apo egjiptian.
- Kur raportohet për këto grupe, të mos përdoren fëmijët që të identifikohen si përfaqësues të komunitetit.
- Imazhet e fëmijëve përforcojnë paragjykimet.
- “A jam duke e trajtuar me dinjitetin që e meriton”.

### 3.3 Raportimi për fëmijët me aftësi të kufizuara

Gjuha e përdorur është prej parimeve më të rëndësishme për mediat e gazetarët kur bëhet fjalë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Zakonisht, pa dashje, me ndonjë shprehje të përdorur në kronika të ndryshme, në publik mund të krijohen perceptime të gabuara për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilat më vonë mund të jenë identifikuese për një grup fëmijësh. Zëri i këtyre fëmijëve duhet të dëgjohet në media, sikurse i të gjithë të tjerëve, megjithatë, roli i mediave duhet të fuqizohet në raportimin sa më të kujdesshëm.

Rekomandime për raportim cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara:

- Të trajtohen me respekt dhe të mos cenohen të drejtat e tyre.
- Kujdes në përdorimin e gjuhës dhe mënyrës se si këta fëmijë portretizohen në media.
- Nuk duhet të përshkruhen si “të sëmurë mendorë”, por fëmijë me vështirësi në mësimnxënie, ose fëmijë me probleme të shëndetit mendor.
- Theksi te vështirësitë dhe problematikat me të cilat ballafaqohen.

### 3.4 Raportimi për fëmijët në fushata zgjedhore

Zakonisht, në prag të zgjedhjeve, nëpër tubime të ndryshme, liderët e partive politike zgjedhin pozicione të veçanta, pamje e fotografi dhe të njëjtat i shpërndajnë në rrjete sociale. Sigurisht, për qëllime elektorale, fotografitë me fëmijë ngërthejnë në vete edhe emocionin për këta liderë politikë. Megjithatë, të njëjtat duhet të shmangen nga mediat. Në raste kur përdorimi i një pamje të tillë bëhet në rrjete sociale nga partitë apo zyrtarët e partive, mediat duhet ta shmangin përdorimin e saj. E nëse përdorimi i saj është me rëndësi aq të madhe, duhet të përdoren modalitetet teknike në mënyrë që identitetit i fëmijës të mos zbulohet.

- Fëmijët nuk duhet të përdoren për fushata. Kur fotografitë publikohen nga liderët e partive, mediat duhet t’i censurojnë.
- Mediat duhet të sigurohen që imazhet e fëmijëve të mos shfrytëzohen negativisht.
- Reklamat ose spotet televizive me fëmijë mund ta dëmtojnë formimin e fëmijëve.

## Përmbledhje:

Përgjegjësia e medias, përveç për ta raportuar të vërtetën mbi fakte dhe parimet etike, është edhe kujdesi kur raporton për kategori të ndjeshme të shoqërisë. Raportimi për fëmijët është sfidues, megjithatë kur fjala është për fëmijët nga grupet e komuniteteve, për fëmijët në varfëri, apo për fëmijët me aftësi të kufizuara, përgjegjësia e gazetarëve dhe mediave është shumëfish më e madhe. Mediat dhe gazetarët duhet të respektojnë parimet profesionale dhe etike kur raportojnë për këto kategori fëmijësh. Duhet të përdorin gjuhë korrekte e të saktë, dhe e cila shmang stigmatizimin dhe krijimin e perceptimeve negative. Identifikimi i fëmijëve në raste të tilla duhet të bëhet vetëm në raste kur interesi i publikut është i madh, me lejen e prindit, dhe në atë mënyrë që të mos lejohet cenimi i privatësisë për fëmijët.

Shembuj të raportimeve nga mediat vendore dhe ato ndërkombëtare dhe imazhe që cenojnë integritetin e fëmijëve:

Raportimi i BBC bazuar në kritere profesionale për virusin Ebola:

<https://www.bbc.co.uk/programmes/b04plw27>

<sup>12</sup> Etika e mediave dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në media – udhëzues nga Save the Children dhe Universiteti i Prishtinës: <https://shorturl.at/KpBW8>



**Publikimi i imazheve të fëmijëve në emisione humanitare si “Jetimat e Ballkanit”**

<https://www.youtube.com/watch?v=S2dvmVBuTZE>

**Raportimi në “Edhe unë jam Kosovë” duke shmangur imazhet e fëmijëve:** <https://www.youtube.com/watch?v=BAy00gg2FUy>

**Raportim profesional për një problematikë të fëmijëve nga komuniteti rom:**

[https://www.youtube.com/watch?v=\\_3veG9fU8mc](https://www.youtube.com/watch?v=_3veG9fU8mc)

**Raportimi që kryesisht bëhet për ta prezantuar jetën e vështirë:**

<https://www.youtube.com/watch?v=kDCAGtITVTo>

**Raportim pozitiv për fëmijët e komunitetit rom që arrijnë sukses në karrierë:**

[https://fb.watch/wnRj\\_qxHQA/](https://fb.watch/wnRj_qxHQA/)

**Raportim profesional për fëmijët me aftësi të kufizuara:**

<https://www.youtube.com/watch?v=QWwacR7xGZ4>

**Raportim për një problem, por që gjuha duhet të jetë e kujdesshme:**

<https://botapress.info/tronditese-prinderit-nuk-i-lejojne-femijet-ne-shkolle-bojkotojne-mesimin-sepse-kane-ne-klase-nje-vajze-me-syndrom-down/>

**Raportimi për fëmijët në fushata:**

<https://reporteri.net/lajme/zgjedhjet-lokale/kandidati-i-aak-se-per-kryetar-te-decanit-i-keqperdore-femijet-per-fushate-zgjedhore-ky-veprim-eshte-i-ndalur-me-ligj/>

Sesioni IV/Temat	Kohëzgjatja	Metodologjia
4. Intervistimi i fëmijëve	20 min	Do të prezantohen modelet më të mira të intervistimit të fëmijëve në media. Po ashtu krahasim me modelet joprofesionale dhe pasojat që mund të shkaktojë intervistimi jo i duhur.
4.1 Zëri i fëmijëve në media	20 min	Rëndësia e prezantimit të fëmijëve në media është e madhe. Por, prindërit duhet të jenë të njoftuar me të drejtat e tyre dhe rolet që kanë institucionet për rregullimin e mediave në Kosovë.
4.2 Gjashtë parimet e UNICEF-it për mbrojtjen e fëmijëve në masmedia	20 min	Në këtë sesion do të prezantohen gjashtë parimet e UNICEF-it për raportimin sa më cilësor dhe mbrojtjen e fëmijëve në masmedia.
4.3 Gjashtë udhëzime për intervistimin profesional të fëmijëve	20 min	Gjashtë udhëzime/rekomandime për mënyrën se si gazetarët duhet ta realizojnë një intervistë profesionale me fëmijët.
4.4 Shtatë rekomandime për raportim cilësor	20 min	Përveç mbrojtjes së fëmijëve, në këtë sesion do të ofrohen rekomandime nga konventat ndërkombëtare për një raportim cilësor ku subjekt janë fëmijët.
4.5 Kodi etik i BBC për raportimin e fëmijëve	20 min	Pjesëmarrësit do të njoftohen me parimet etike që ndjek BBC për raportimin për fëmijët.

## Objektivat:

- Njohja me parimet kryesore nga organizatat dhe mediat vendore e ato ndërkombëtare për raportim sa më cilësor dhe mbrojtjen e fëmijëve në media.
- Njohja me rëndësinë e madhe të intervistimit profesional të fëmijëve, dhe krahasimi me rastet ku intervistimi joprofessional ka shkaktuar dëme të mëdha.
- Njohja me kodin etik të BBC për raportim cilësor dhe mbrojtjen e fëmijëve në media.

## Rezultatet e pritura:

Diskutim dhe prezantim i rekomandimeve më të mira për mënyrën se si duhet të intervistohen fëmijët në media, si të shmangët ndikimi negativ, dhe pasojat që ka intervistimi joprofessional. Njohja dhe të kuptuarit e saktë të të gjitha praktikave ndërkombëtare për raportim cilësor dhe mbrojtjen e fëmijëve në media.

## 4. Intervistimi i fëmijëve

Njëra prej detyrave më të vështira për gazetarët lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në masmedia është intervistimi i fëmijëve. Ka raste kur gazetarët nuk u kushtojnë rëndësi detajeve, duke bërë ndonjë pyetje e cila vendos fëmijët në pozicion të palakmueshëm. Si rezultat, nga presioni, fëmijët mund të japin përgjigje të ndryshme, të cilat më pas bëhen virale dhe pasojat për fëmijët janë të mëdha.

Në këtë sesion do të diskutohet për njërin prej rasteve ku intervistimi i fëmijëve në formën jo të duhur ka shkaktuar pasoja të mëdha. Fjala është për trazirat e marsit të vitit 2004, ku tre fëmijë kishin humbur jetën në lumin Ibër. Një raport i OSBE-së kishte konstatuar se faktori kryesor që nxiti trazirat e marsit ishte raportimi i mediave. Ky raport kishte evidentuar një intervistë të Televizionit Publik me një fëmijë që ishte dëshmitar i ngjarjes. Pyetjet e gazetarit, intervistimi i fëmijës që sapo kishte shpëtuar nga një fatkeqësi kulmuan me keqinformim nga mediat duke nxitur edhe më shumë tensionet.<sup>13</sup> OSBE-ja kishte konstatuar se raportimi i mediave ishte joprofesional, duke shtuar deklarata nga të intervistuarit të cilat ata nuk i kishin thënë. Gjithsesi, intervistimi i fëmijëve në gjendje të tronditjes mendore, apo pas situatave të tilla, nuk preferohet.

### 4.1 Zëri i fëmijëve në media

Sfidat e përmendura dhe kujdesi që duhet të kenë mediat e gazetarët në raport me mbrojtjen e fëmijëve në asnjë mënyrë nuk duhet të krijojnë përshtypjen se duhet të ketë prezencë më të vogël të fëmijëve në media. Në fakt, është krejtësisht e kundërta. Zëri i fëmijëve në media duhet të dëgjohet çdo ditë e më shumë, sepse vetëm kjo është mënyra se si edhe raportimi për ta mund të përmirësohet. Ajo që kërkohet është vetëm respektim i parimeve etike e profesionale, ndërlidhur me obligimet ligjore që dalin nga legjislacionet në fuqi.

Mediat, përveç raportimit, kanë edhe një tjetër funksion. Duhet t'i edukojnë fëmijët për rolin që e kanë në raportimin e së vërtetës dhe të drejtat që kanë fëmijët në media. Gjithashtu, duhet të raportojnë e t'i edukojnë edhe prindërit për të drejtat e tyre në rast se shkelet ndonjë parim kur raportohet për fëmijët. Prindërit duhet të njoftohen për rolin që ka Komisioni i Pavarur për Media, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës e mekanizmat e tjerë.

Është obligim i mediave që të krijojnë një hapësirë ideale për fëmijët, duke kontribuar gjithashtu që ajo hapësirë të mos keqpërdoret, por të përdoret në bazë të parimeve etike e profesionale.

### 4.2 Gjashtë parimet e UNICEF-it për mbrojtjen e fëmijëve në masmedia

Organizata UNICEF ka gjashtë parime lidhur me mbrojtjen dhe raportimin për fëmijët në masmedia:<sup>14</sup>

- Respektoni dinjitetin dhe të drejtat e fëmijëve në çdo rrethanë.
- Gjatë raportimit, kujdesuni për privatësinë dhe vendimet që i prekin direkt fëmijët.
- Mbroni interesat e fëmijëve.
- Ofroni fëmijëve të drejtën që pikëpamjet e tyre të merren parasysh në përputhje me moshën dhe pjekurinë.
- Konsultohuni me ata që janë më të afërt me situatat e fëmijëve. Mos publikoni kronika që rrezikojnë fëmijët, vëllezërit, motrat e tyre, edhe kur identiteti i tyre nuk ndryshohet.

### 4.3 Gjashtë udhëzime për intervistimin e fëmijëve

- Mos i bëni dëm asnjë fëmije. Shmangi pyetjet, qëndrimet gjykuese dhe që riaktivizojnë dhimbjet e tyre.
- Mos bëni diskriminim në zgjedhjen e fëmijëve për shkak të gjinisë, racës, fesë.
- Mos kërkoni nga fëmijët të tregojnë histori që nuk janë të tyre.
- Shpjegoni prindërve qëllimin e intervistës.
- Merrni leje nga prindërit ose kujdestari (shkrim, fotografi, video)
- Kushtoni vëmendje se ku intervistohet fëmija.

<sup>13</sup> Raporti i OSBE-së: <https://shorturl.at/DpJuj>

<sup>14</sup> Parimet profesionale për raportim sipas UNICEF-it: <https://www.unicef.org/eca/media/ethical-guidelines>

## 4.4 Shtatë rekomandime për raportim cilësor

- Mos stigmatizoni. Shmangni rrezikun për abuzim ose diskriminim.
- Jepni gjithmonë kontekst të qartë për historinë dhe imazhin e fëmijës.
- Ndryshoni emrin kur raportoni për ndonjë viktimë të abuzimit etj.
- Nëse vendosni ta përdorni identitetin, ai duhet të mbrohet nga dëmet e tjera.
- Konfirmoni saktësinë e asaj që deklaron fëmija në raste të ndjeshme.
- Kur mendoni se një fëmijë është në rrezik, raportoni përgjithësisht dhe jo individualisht, sepse kjo shkakton traumë.

## 4.5 Kodi etik i BBC

- Jepini përparësi gjithmonë sigurisë së fëmijëve.<sup>15</sup>
- Veproni brenda kufijve profesionalë dhe sigurohuni për kontaktin me të miturit.
- Mos merrni përgjegjësi për një fëmijë ose të rritur të pambrojtur. Nëse fëmija ka nevojë për kujdes, lajmëroni prindin. Merrni përgjegjësi vetëm në raste urgjente.
- Kujdes me gjuhën. Duhet të jetë gjuhë e përshtatshme. Shmangni favorizimin.
- Trajtoni fëmijët në mënyrë të drejtë, pa paragjykim e diskriminim.

### Përmbledhje:

Mediat kanë funksionin kryesor për dhënien e hapësirës që zëri i fëmijëve të dëgjohej, duke përfshirë edhe edukimin e prindërve për të drejtat që kanë në rast se të drejtat e fëmijëve të tyre shkelen nga mediat.

UNICEF-i, Save the Children e organizata të tjera, BBC, Konventat vendore e ato ndërkombëtare, platformat e njohura mediale, kanë të përcaktuara në mënyrë strikte rekomandimet dhe udhëzimet që raportimi për fëmijët të jetë cilësor e profesional.

Mediat në Kosovë nuk kanë një kod etik të tyre, por funksionojnë me kodet etike të KPM-së dhe KMSHK-së.

Që fëmijët në masmedia të jenë të mbrojtur nga lajmet joprofesionale, nga raportimet negative, duhet punë e përbashkët mes organizatave, mediave dhe institucioneve.

<sup>15</sup> Kodi etik i BBC: <https://www.bbc.com/aboutthebbc/reports/policies/childprotection>

## Lista e materialeve/burimeve

Raporti i Save the Children: <https://www.dukagjini.com/save-the-children-tiktok-u-hapesira-ku-bullizohen-me-se-shumti-femijet-ne-kosove/>

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve - <https://shorturl.at/v80lz>

Kushtetuta e Kosovës - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës - <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2809>

Rregullorja e KPM-së për Mbrojtjen e Fëmijëve: <https://shorturl.at/9x9FZ>

Kodi i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës: <https://shorturl.at/XjsMw>

Raporti i Hibrid: <https://shorturl.at/TBBPY>

Artikulli në media: <https://kallxo.com/lajm/loja-ne-tiktok-dyshohet-se-nxiti-edhe-tri-nxenese-ne-gjakove-te-lendojne-veten-ne-duar/>

Manual për mediat dhe gazetarët lidhur me raportimin për fëmijët nga Instituti Shqiptar i Medias - <https://shorturl.at/sDZ4c>

Reportazh i BBC për fëmijët me Ebolë në Afrikë - <https://www.bbc.co.uk/programmes/b04plw27>

Etika e mediave dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në media – udhëzues nga Save the Children dhe Universiteti i Prishtinës: <https://shorturl.at/KpBW8>

Raporti i OSBE-së: <https://shorturl.at/DpJuj>

Parimet profesionale për raportim sipas UNICEF-it: <https://www.unicef.org/eca/media/ethical-guidelines>

Kodi etik i BBC: <https://www.bbc.com/aboutthebbc/reports/policies/childprotection>







Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**